



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e hënë, datë 23.06.2025, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	METAJ	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Rinovimin e licencës të shoqërisë “Radio Klan” sh.a., për subjektin audio analog kombëtar “Radio Klan”. **(Vendim nr. 55, datë 23.06.2025)**
2. Rinovimin e autorizimit të subjektit person fizik Shpresa Boriçi, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “TV Tërbuf”, si dhe zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit në: *“Njësinë Administrative Grabian (të Bashkisë Divjakë)”*. **(Vendim nr. 56, datë 23.06.2025)**
3. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Click.al” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Click.al”, në *“Njësinë administrative Ksamil (të bashkisë Sarandë), Njësinë administrative Delvinë (të bashkisë Delvinë) dhe Njësinë administrative Markat (të bashkisë Konispol)”*. **(Vendim nr. 57, datë 23.06.2025)**
4. Shtyrjen e shqyrtimit të vendimarrjes në mbledhjen e ardhshme të bordit për dhënien e autorizimit shoqërisë “Shtëpia e Futbollit” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv online, mbështetur në rrjet IP (OTT) “FSHF TV”, për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 23 Qershor 2025